

# CENTRUM

revistë shkencore  
научно списание  
scientific magazine

**5**



QENDRA PËR MIRËKUPËTIM DHE BASHKËPUNIM INSTITUCIONAL  
ЦЕНТАР ЗА РАЗБИРАЊЕ И ИНСТИТУЦИОНАЛНА СОРАБОТКА  
CENTER FOR UNDERSTANDING AND INSTITUTIONAL COOPERATION

## CENTRUM 5

---

## CENTRUM 5

---

**Kryeredaktor / Главен уредник / Editor in chief /**

Muhamed Murtezi, MA

**Këshilli shkencor/ Научен одбор/ Scientific committee/**

Anas Altikriti, PhD (Great Britain)

Michael Privot, PhD (Belgium)

Ali Kahraman, PhD (Turkey)

Murat Ali Karavelioğlu, PhD (Turkey)

Vehbi Hoti, PhD (Albania)

Regjina Gokaj, PhD (Albania)

Ahmet Alibašić, PhD (Bosnia and Herzegovina)

Munir Drkić, PhD (Bosnia and Herzegovina)

Milazim Krasniqi, PhD (Kosovo)

Hysen Matoshi, PhD (Kosovo)

Edmond Beqiri, PhD (Kosovo)

Vllado Kambovski, PhD-Academician (Macedonia)

Ferid Muhiq, PhD (Macedonia)

Bajram Pollozhani, PhD (Macedonia)

Nazmi Maliqi, PhD (Macedonia)

Afrim Osmani, PhD (Macedonia)

**Këshilli redaktues/ Уредувачки Одбор/ Editorial board/**

Bashkim Aliu, PhD

Milazim Mustafa, MA

Kujtim Kasami, MA

Muhamed Jonuzi, MA

Muhamed Murtezi, MA

**Botues / Publisher / Издавач**

Qendra për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim Institucional

Center for Understanding and Institutional Cooperation

Центар за Разбирање и Институционална Соработка

## CENTRUM 5

---

**Përgatitja kompjuterike/Computer arrangement:**

Jusuf Saliu

**Shtypi/Print:**

Furkan ISM - Shkup

**Adresa/Address:**

Bul. Krste Misirkov 57a, Lok. 3  
1000 Shkup

**Kontakt/Contact:**

Tel: + 389 2 3232 186

e-mail: [infoqmbi@gmail.com](mailto:infoqmbi@gmail.com)

web: [www.qmbi.org](http://www.qmbi.org)

# CENTRUM

## 5 / 2016

---

1857-8640 (Print)

UDC 3(497.7:4-672 EU)

1857-9396 (Online)

**Abstracting & Indexing**

**1. National and University Library "St. Clement of Ohrid" - Skopje**

**2. Google Scholar**

**Përmbajtja/Содержина/Content**

Mr.sc. Ahmet IMAMI

REFORMAT NË SISTEMIN PROKURORIAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS .....	9
РЕФОРМИТЕ ВО ОБВИНЕТЕЛСКИОТ СИСТЕМ НА РЕПУБЛИКА КОСОВО .....	9
REFORMS OF THE PROSECUTORIAL SYSTEM IN KOSOVO .....	9

Aleksandar KITANOVSKI, PhD

Prof. Aleksandar DONCEV, PhD

IMIGRIMI ILEGAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË .....	22
ИЛЕГАЛНА ИМИГРАЦИЈА ВО РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА .....	22
ILLEGAL IMMIGRATION IN REPUBLIC OF MACEDONIA.....	22

М-р Марија Вељовска Кондовска

Проф. Д-р Александар Дончев

Доц. Д-р Александар Китановски

SFIDAT E SIGURISË DHE KRIZA ME MIGRANTËT NË UNIONIN EVROPIAN.....	34
БЕЗБЕДНОСНИТЕ ПРЕДИЗВИЦИ И МИГРАНТСКАТА КРИЗА ВО ЕВРОПСКАТА УНИЈА .....	34
SECURITY CHALLENGES AND MIGRANT CRISIS IN THE EUROPEAN UNION .....	34

М-р Amir Dalipi

Doc. d-r Naser Etemi

ZBATIMI I PROGRAMIT ANTIKORRUPSION NGA SEKTORI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM DHE STANDARDEVE PROFESIONALE .....	49
ПРИМЕНА НА АНТИКОРУПЦИСКА ПРОГРАМА НА СЕКТОРОТ ЗА ВНАТРЕШНА КОНТРОЛА И ПРОФЕСИОНАЛНИ СТАНДАРДИ .....	49
APPLICATION OF ANTI-CORRUPTION PROGRAM BY SECTOR FOR INTERNAL CONTROL AND PROFESSIONAL STANDARDS .....	49

Анета Атанасовска

AUTORIZIMI NË KONËN E DOMINATIT .....	58
ПОЛНОМОШНОТО (MANDATUM) ВО ВРЕМЕТО НА ДОМИНАТОТ .....	58
MANDATE (mandatum) IN THE PERIOD OF DOMINATE .....	58

Arlinda Kadri-Shahinoviq

TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PALËVE NË MARTESË ME ELEMENT NDËRKOMBËTAR .....	77
ПРАВА И ОБВРСКИ НА СТРАНИТЕ ВО БРАКОТ СО МЕЃУНАРОДЕН ЕЛЕМЕНТ .....	77
RIGHTS AND OBLIGATION OF PARTIES IN MARRIAGE WITH INTERNATIONAL ELEMENT .....	77

## CENTRUM 5

---

MSc. Atifete Thaqi	
MSc.Shpresa Feraj	
MSc.Xheladin Gashi	
<b>RËNDËSIA E SHPËRBLIMIT TË PUNONJËSVE NË NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME NË KOSOVË .....</b>	<b>94</b>
<b>ВАЖНОСТА НА НАГРАДУВАЊЕТО НА ВРАБОТЕНИТЕ ВО МАЛИТЕ И СРЕДНИТЕ ПРЕТПРИЈАТИЈА ВО КОСОВО .....</b>	<b>94</b>
<b>THE IMPORTANCE OF REMUNERATION OF EMPLOYEES IN SMALL AND MEDIUM ENTERPRISES IN KOSOVO .....</b>	<b>94</b>
Prof. dr. Bashkim SELMANI	
<b>SISTEMI PROCEDURAL DHE PROCESI JURIDIKO-CIVIL I PALËVE NË PROCESET GJYQËSORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË .....</b>	<b>107</b>
<b>ПРОЦЕСНИОТ СИСТЕМ И ГРАЃАНСКО-ПРАВНИОТ ПРОЦЕС НА СТРАНКИТЕ ВО СУДСКИТЕ ПОСТАПКИ ВО РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА .....</b>	<b>107</b>
<b>PROCEDURAL SYSTEM AND CIVIL JUSTICE PROCESS OF PARTIES IN THE PROCEEDINGS IN THE REPUBLIC OF MACEDONIA.....</b>	<b>107</b>
Bujar Adili, MA	
<b>DISA PARIME THEMELORE TË ARSIMIT INTERKULTUROR.....</b>	<b>134</b>
<b>НЕКОИ ОСНОВНИ НАЧЕЛА ИНТЕРКУЛТУРНОТО ОБРАЗОВАНИЕ .....</b>	<b>134</b>
<b>SOME BASIC PRINCIPLES OF THE INTERCULTURAL EDUCATION .....</b>	<b>134</b>
Donjeta Morina, MSc	
<b>SHKAQET DHE PASOJAT E PËRFSHIRJËS SË FËMIJËVE NË TREGUN E PUNËS - RASTI I KOSOVËS.....</b>	<b>143</b>
<b>ПРИЧИНИТЕ И ПОСЛЕДИЦИТЕ НА ВКЛУЧУВАЊЕТО НА ДЕЦАТА ВО ПАЗАРОТ НА ТРУДОТ – СЛУЧАЈОТ НА КОСОВО .....</b>	<b>143</b>
<b>CAUSES AND CONSEQUENCES OF THE INVOLVEMENT OF CHILDREN IN THE LABOR MARKET - THE CASE OF KOSOVO .....</b>	<b>143</b>
Doc. dr Dragana Randelović	
Msc. Lemane Mustafa	
<b>ARTI I TË SHKRUARIT SHKURTËR NË PROCEDURAT GJYQËSORE .....</b>	<b>165</b>
<b>УМЕТНОСТА НА КРАТКО ПИШУВАЊЕ ВО СУДСКИТЕ ПОСТАПКИ .....</b>	<b>165</b>
<b>THE ART OF BRIEF WRITING FOR LITIGATION .....</b>	<b>165</b>
Driton Islami	
<b>MASAT OPERATIVO-TAKTIKE KRIMINALISTIKE DHE VEPRIMET NETIMORE PËR ZBULIMIN E KRIMINALITETIT SEKSUAL.....</b>	<b>180</b>
<b>ОПЕРАТИВНО-ТАКТИЧКИ КРИМИНАЛИСТИЧКИ МЕРКИ И ИСТРАЖНИТЕ ПОСТАПКИ ВО ОТКРИВАЊЕ НА СЕКСУАЛНИОТ КРИМИНАЛ .....</b>	<b>180</b>
<b>PROVISIONS OPERATIVO- TACTICAL FORENSIC AND INVESTIGATIVE ACTIONS RECOVERY SEXUAL CRIME .....</b>	<b>180</b>

## CENTRUM 5

---

Elizabeta Spiroska M.Sc.

Ivan Bimbilovski, Ph.D.

<b>NDËMJETËSIMI LEHTËSUES DHE EVALUATIV NË TË DREJTËN CIVILE .....</b>	<b>202</b>
<b>ОЛЕШУВАЧКА И ЕВАЛУАТИВНА МЕДИЈАЦИЈА ВО ГРАЃАНСКОТО ПРАВО .....</b>	<b>202</b>
<b>FACILITATIVE AND EVALUATIVE MEDIATION IN CIVIL LAW .....</b>	<b>202</b>

Esat Elezi

<b>ASPEKTET E MENAXHIMIT CIVIL ME KRIZAT BRENDA BE .....</b>	<b>223</b>
<b>АСПЕКТИ НА ЦИВИЛНОТО МЕНАЏИРАЊЕ СО КРИЗИ ВО РАМКИТЕ НА ЕУ .....</b>	<b>223</b>
<b>ASPECTS OF THE CIVIL CRISIS MANAGEMENT WITHIN THE EU .....</b>	<b>223</b>

Fisnik Morina, MSc

<b>PËRSHTATSHMËRIA E POLITIKAVE KREDITORE TË BANKAVE KOMERCIALE NË RAPORT ME PERFORMANCEN E NVM-VE NË KOSOVË .....</b>	<b>235</b>
<b>ПРИЛАГОДНОСТА НА КРЕДИТОРНИТЕ ПОЛИТИКИ НА КОМЕРЦИЈАЛНИТЕ БАНКИ ВО ОДНОС НА ПЕРФОРМАНСАТА НА МСП ВО КОСОВО.....</b>	<b>235</b>
<b>APPROPRIATENESS OF CREDIT POLICIES OF COMMERCIAL BANKS IN RELATION TO THE PERFORMANCE OF SMEs IN KOSOVO.....</b>	<b>235</b>

Fisnik Sadiku, MA

Besnik Lokaj, MA

Shpend Zogaj, MA (can.)

<b>NDIKIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE NË RRITJEN E TERRORIZMIT BASHKËKOHOR.....</b>	<b>258</b>
<b>ВЛИЈАНИЕТО НА ИНФОРМАТИЧКАТА ТЕХНОЛОГИЈА ВО РАСТОТ НА СОВРЕМЕНИОТ ТЕРОРИЗАМ .....</b>	<b>258</b>
<b>THE IMPACT OF INFORMATION TECHNOLOGY IN THE GROWTH OF CONTEMPORARY TERRORISM .....</b>	<b>258</b>

Gëzim Xhambazi

<b>REORGANIZIMI FAMILJAR I NDIHMËS SOCIALE – BARAZIA GJINORE .....</b>	<b>270</b>
<b>СЕМЕЈНА РЕОРГАНИЗАЦИЈА ЗА СОЦИЈАЛНА ПОМОШ - РОДОВА ЕДНАКВОСТ ....</b>	<b>270</b>
<b>FAMILY REORGANIZATION FOR A SOCIAL WELFARE - GENDER EQUALITY.....</b>	<b>270</b>

Mr. Kujtim Kasami

<b>SFIDAT E DEMOKRACISË LIBERALE.....</b>	<b>278</b>
<b>ПРЕДИЗВИЦИТА НА ЛИБЕРАЛНАТА ДЕМОКРАТИЈА.....</b>	<b>278</b>
<b>CHALLENGES OF LIBERAL DEMOCRACY .....</b>	<b>278</b>

Mersel Bilalli

<b>REGJIMET E DETIT NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE .....</b>	<b>286</b>
<b>РЕЖИМИТЕ НА МОРЕТО ВО МЕЃУНАРОДНОТО ПРАВО.....</b>	<b>286</b>
<b>THE SEA REGIME IN THE INTERNATIONAL LAW .....</b>	<b>286</b>

## CENTRUM 5

---

Doc.dr. Mevledin MUSTAFI

<b>SIGURIA PUBLIKE DHE FUNKSIONET E SË DREJTËS PENALE NË MBROJTJE TË SHOQËRISË BASHKËKOHORE .....</b>	<b>298</b>
<b>JAVHATA BEZBEDNOST И ФУНКЦИИТЕ НА КАЗНЕНОТО ПРАВО ВО ОДБРАНА НА СОВРЕМЕНОТО ОПШТЕСТВО.....</b>	<b>298</b>
<b>PUBLIC SECURITY AND THE FUNCTIONS OF THE CRIMINAL LAW IN DEFENDING THE COTEMPORARY SOCIETY.....</b>	<b>298</b>

Murat M. ALIU

<b>NJË ANALIZË LIBRIT “MBI POLITIKËN” TË AUTORES CHANTAL MOUFFE .....</b>	<b>311</b>
<b>АНАЛИЗА НА КНИГАТА “ЗА ПОЛИТИКАТА” ОД АВТОРОТ ШАНТАЛ МУФЕ .....</b>	<b>311</b>
<b>AN ANALYSIS OF THE BOOK “ON THE POLITICAL” OF THE AUTHOR CHANTAL MOUFFE .....</b>	<b>311</b>

Neritan Turkeshi PhD

Ajsel Jakupi, MA

<b>ROLI I MARKETINGUT NDAJ TURIZMIT .....</b>	<b>324</b>
<b>УЛОГАТА НА МАРКЕТИНГОТ ВРЗ ТУРИЗМОТ.....</b>	<b>324</b>
<b>THE ROLE OF MARKETING ON TOURISM .....</b>	<b>324</b>

д-р Никола Мицковски

д-р Ристо Речкоски

<b>BAZAT NORMATIVE TË EKSPERTIZËS NË PROCEDURËN PENALE NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS.....</b>	<b>337</b>
<b>НОРМАТИВНИ ОСНОВИ НА ВЕШТАЧЕЊЕТО ВО КРИВИЧНАТА ПОСТАПКА НА СОЕДИНЕТИТЕ АМЕРИКАНСКИ ДРЖАВИ.....</b>	<b>337</b>
<b>LEGAL BASES OF EXPERTISE IN THE CRIMINAL PROCEDURE IN THE UNITED STATES OF AMERICA.....</b>	<b>337</b>

Qazime Sherifi

<b>ANGAZHIMI DIPLOMATIK I SHBA NË KONLIKTIN NDËRETNIK NË BeH.....</b>	<b>353</b>
<b>ДИПЛОМАТСКИОТ АНГАЖМАН НА САД ВО МЕЃУЕТНИЧКИОТ КОНФЛИКТ ВО БИХ .....</b>	<b>353</b>
<b>THE US DIPLOMATIC ENGAGEMENT IN INTERETHNIC CONFLICT OVER BH .....</b>	<b>353</b>

MSc. Skender Mustafi

<b>MARKETINGU ISLAM: NË MES TË DEFINUARIT, TË KUPTUARIT DHE TË APLIKUARIT .....</b>	<b>365</b>
<b>ИСЛАМСКИ МАРКЕТИНГ: МЕЃУ ДЕФИНИРАЊЕТО, РАЗБИРАЊЕТО И ПРИМЕНАТА.....</b>	<b>365</b>
<b>ISLAMIC MARKETING: BETWEEN DEFINING, UNDERSTANDING AND APPLYING .....</b>	<b>365</b>



347.963-027.1(497.115)

Mr.sc. Ahmet IMAMI<sup>1</sup>

## REFORMAT NË SISTEMIN PROKURORIAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

### РЕФОРМИТЕ ВО ОБВИНЕЛСКИОТ СИСТЕМ НА РЕПУБЛИКА КОСОВО

#### REFORMS OF THE PROSECUTORIAL SYSTEM IN KOSOVO

##### **Abstract**

Reforms of the prosecutorial system in Kosovo have brought different innovations. Although it has been a difficult transition from the system that has been in the past to the new prosecution system, but anyway, the reforms made in this system are considered successful.

By analyzing this reform better, I think that this reform has had a positive impact on the prosecutorial system of Kosovo, since the former has had a system prokuroriral organization and operation of prosecution more complicated. I also think that this reform will also affect the professionalism of prosecutors, since the new system of prosecution provided the reappointment process to prosecutors after three years from the date appointed as prosecutors youth, which motivates prosecutors to work on the most efficient and in a more professional way, in order to gain permanent status to the prosecutor.

**Keywords:** Reforms of the prosecutorial system in Kosovo, since the new system of prosecution provided, motivates prosecutors to work, efficient and in a more professional way, order, gain, permanent, status.

---

<sup>1</sup> Autori është asistent në Fakultetin Juridik të Universitetit Publik të Gjilanit “KADRI ZEKA”, në Gjilan.

## **Hyrje**

Sistemi prokurorial në shtetet demokratike është një prej shtyllave kryesore të shtetit. Duke u bazuar në rëndësinë e këtij sistemi në çdo shtet, ky sistem duhet të jetë i pavarur, të mos ketë ndikime politike si dhe të zhvillohet dhe të funksionoj duke u bazuar në parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Pasi që në Republikën e Kosovës janë bërë disa reforma në sistemin prokurorial, atëherë kam parë të rrugës që të bëjë një punim shkencor lidhur me këto reforma, të titulluar: “Reformat në sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës”. Në këtë punim do t’i trajtoj rrënjësisht reformat të cilat janë bërë në sistemin prokurorial në Republikën e Kosovës, përkatësisht në organizimin dhe funksionimin e tij në të gjitha instancat e prokurorive të Republikës së Kosovës, të cilat konsiderohen si sukses brenda sistemit të drejtësisë së shtetit të Kosovës. Qëllimi i këtij punimi shkencor është të bëhet një analizë në mes të sistemit prokurorial në të kaluarën si dhe sistemit prokurorial sot, pasi që reforma e janarit të vitit 2013 në këtë sistem ka sjellë risi të ndryshme, ku kemi dallime të mëdha si në strukturën ashtu edhe në funksionimin e prokurorive të Republikës së Kosovës. Mendoj se ka rëndësi të madhe të bëhen punime shkencore lidhur me sistemin prokurorial në Republikën e Kosovës, pasi që Kosova është një shtet i ri dhe ka nevojë për një sistem prokurorial të mirëfilltë, të pavarur, apolitik dhe të bazuar në Ligjet e saj si dhe në Kushtetutën e saj. Do të mundohem ta bëjë një punim sa me të qartë për lexuesit e këtij punimi, me qëllim që të gjithë të interesuarit të kenë mundësi që të marrin njohuri themelore lidhur me sistemin prokurorial në përgjithësi si dhe me reformat që janë bërë në këtë sistem të Republikës së Kosovës nga janari i vitit 2013. Prandaj, në një pjesë të konsiderueshme do të përdorë metodën krahasimore, metodën analitike, metodën sociologjike, metodën normative, metodën historike, metodën e intervistës dhe metodën komparative gjyqësore-juridike.

## **2.Organizimi dhe funksionimi i zyrave të prokurorive**

Prokuroria e Shtetit, është një institucion kushtetues, i pavarur, me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekje penale të personave të akuzuar për vepra penale ose për ndonjë vepër tjetër si dhe bënë paraqitjen e akuzës në gjyq, në emër të shtetit. Prokuroria i ushtron funksionet nëpërmjet prokurorëve të saj. Organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë e bënë Prokurori i Shtetit, me strukturë të centralizuar, ku përfshihen zyra e Prokurorit të Shtetit, Këshilli Prokurorial dhe Prokuroritë e

instancave më të ulëta.<sup>2</sup> Prokuroria, në çdo shtet, paraqet organin kryesor të ndjekjes ndaj kryesve të veprave penale. Ky organ përbën zinxhirë shumë të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë. Detyra kryesore e saj është ndjekja e veprave penale sipas detyrës zyrtare dhe ofrimi i provave për vërtetimin e fakteve të caktuara nga ana e gjykatave përkatëse.<sup>3</sup> Sipas parimit të akuzativitetit të procedurës penale, kjo procedurë në parim nuk mund të fillojë dhe të zhvillohet, pa iniciativën e Prokurorit të Shtetit, do të thotë pa ndjekjen e kryesve të veprave penale si dhe pa ofrimin e provave pranë gjykatës për vërtetimin e fakteve, nga ana e Prokurorisë së Shtetit nuk mundet as të fillojë, e as të zhvillohet procedura penale.<sup>4</sup>

Po ashtu, Prokurori i Shtetit, respekton përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore. Mandati fillestar për prokuror është trevjeçar. Në rast të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar me ligj, përveç nëse shkarkohet më herët në rastet e përcaktuara me ligj. Prokurorët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave, ndërsa Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçarë, pa mundësi riemërimi.<sup>5</sup> Prokurorët e shtetit janë të lidhura në vijë vertikale në mes veti, do të thotë ekziston hierarkia në prokuroritë nga instanca me e lartë, në instancë më të ulët. Në ushtrimin e funksionit të ndjekjes së kryerësve të veprave penale dhe të veprave tjera të caktuara me ligj, prokurori i shtetit, përcakton dhe merr masat e nevojshme, në bashkëpunim me organet tjera të autorizuar, lidhur me zbulimin e këtyre veprave penale dhe kryerësve të atyre, veprave penale të cilat janë të përcaktuara me ligj.<sup>6</sup>

Kjo do të thotë se, prokurori i instancës më të lartë në pajtim me ligjin, mund t'i japë prokurorit të instancës më të ulët udhëzime të

---

<sup>2</sup> Sadik Haxhiu – Flamur Hyseni, “Sistemi Gjyqësor në Republikën e Kosovës”, Gjilan 2013, f. 74.

<sup>3</sup> Arsim Bajrami, “Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës”, Prishtinë 2011, f. 327.

<sup>4</sup> Arsim Bajrami – Xhavit Shala, “Doracakut për përgatitjen e provimit të Jurisprudencës”, Prishtinë 2009, f. 18.

<sup>5</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 109.

<sup>6</sup> Arsim Bajrami – Xhavit Shala, “Doracakut për përgatitjen e provimit të Jurisprudencës”, Prishtinë 2009, f. 19.

obligueshme për punën e tij dhe të marrë përsipër edhe ushtrimin e punëve të caktuara, për të cilat është kompetent prokurori i ulët publik, dhe në këtë rast, prokurori publik i instancës më të lartë, në momentin e marrjes përsipër ushtrimin e punëve të prokurorit publik të instancës më të ulët, ai punën e marrë e konsideron si të ishte në kompetencën e tij.<sup>7</sup> Prokurorët, kanë kompetencat dhe detyrat e tyre, e ato janë:

- Ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;

- Zbatimi i standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;

- Sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale dhe bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe kodin e etikës profesionale;

- Ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të Prokurorit të Shtetit;

- Mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve dhe personave të dënuar;

Ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale;

- Marrjen e vendimeve mbi inicimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale;

- Ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës;

- Ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore;

- Bashkëpunimin me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera;

- Ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera, të cilat janë të dënueshme me ligj.<sup>8</sup>

Ndërsa, duke u bazuar në KPP, kompetencat e prokurorit publik, në aspektin teorik, mund të ndahen në dy grupe: Në grupin e parë të kompetencave të prokurorit publik hyjnë kompetencat themelore, të cilat kanë për qëllim hetimin e veprave penale dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale; Në grupin e dytë të kompetencave të prokurorit publik hyjnë ato kompetenca që kanë për qëllim ndjekjen e veprave

---

<sup>7</sup> Iljaz Ramajli, “Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës”, Prishtinë 2004, f. 37.

<sup>8</sup> Ligji për Prokurorin e Shtetit, nr. 03/L-225, neni 7, paragrafi 1-11.

penale, sipas detyrës zyrtare, ose me kërkesën e të dëmtuarit, ku në këto kompetenca hyjnë:

- Ndërmarrja e masave të nevojshme për t'i zbuluar veprat penale dhe gjetjen e kryesve të tyre;

- Paraqitja e akuzës para organit kompetent, përkatësisht gjykatës;

- Paraqitja e ankesës kundër vendimeve gjyqësore të cilat nuk kanë marrë formën e prerë, si dhe paraqitja e mjeteve të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë;

- Ndërmarrja e veprimeve të tjera të cilat janë të përcaktuara me ligj.

Pavarësia e prokurorisë publike është e garantuar edhe me ligj, pasi që ligjvënësi ka përcaktuar, në mënyrë taksative, se është e ndaluar ndikimi në drejtimin e veprimeve të prokurorisë publike në trajtimin e çështjeve penale. Në këtë mënyrë, ligjvënësi, ka paraparë që prokurori publik duhet t'i hetoj veprat penale duke i analizuar mirë provat dhe faktet të cilat janë në dëm apo në dobi të pandehurit, si dhe të bëhet mbledhja e provave dhe fakteve duke i respektuar rregullat e procedurës penale.<sup>9</sup>

Rregullimi i prokurorisë publike, bazohet në disa parime të veçanta, të cilat janë: parimi i hierarkisë, që do të thotë se prokuroria publike e rangut më të ulët, varet nga prokuroria publike e rangut më të lartë, si dhe ky parim manifestohet në dy mënyra: në hierarki të jashtme dhe hierarki të brendshme. Hierarkia e jashtme nënkupton që marrëdhëniet e prokurorisë së rangut më të ulët dhe prokurorisë së rangut më të lartë, janë të rregulluara në atë mënyrë që prokuroria publike e rangut më të lartë mund të ndikoj në punën e prokurorisë publike të rangut më të ulët duke i dhënë udhëzime për ndonjë rast konkret, ndërsa hierarkia e brendshme nënkupton që në krye të prokurorisë është kryeprokurori i cili koordinon punën e prokurorëve publikë brenda prokurorisë përkatëse; parimi i devolucionit i cili nënkupton që prokurori publik më i lartë, ka të drejtë që t'i ushtroj funksionet e prokurorit publik më të ulët; parimi i substitucionit që nënkupton gjithashtu të drejtën e prokurorit publik të rangut më të lartë që të ushtroj funksionin e ndjekjes, si dhe të bëjë bartjen e çështjes penale nga një prokurori publike të rangut më të ulët në prokurorinë tjetër të rangut të njëjtë; parimi i vendosjes në

---

<sup>9</sup> Azem Hajdari, "E drejta e Procedurës Penale", Prishtinë 2010, f. 115.

mënyrë monokratë i cili ka të bëjë me mënyrën e kryerjes së funksionit të ndjekjes të prokurorit publik. Çka do të thotë se prokurori publik mund ta kryej funksionin e ndjekjes penale vet ose t'ia besojë ndonjërit prej prokurorive të cilat ushtrojnë funksionin në prokurorinë e njëjtë. Sipas këtij parimi secili prokurorë vepron vetë dhe është përgjegjës për veprimet e veta.<sup>10</sup>

Procedura penale fillohet vetëm me vendim të prokurorit të shtetit kur ekziston dyshim i bazuar se është kryer vepër penale. Prokurori i shtetit mund të fillojë procedurën penale pas marrjes së informacionit nga policia, institucioni tjetër publik, institucioni privat, qytetari, media, nga informacioni i marrë në një procedurë tjetër penale ose pas ankimit ose propozimit të dëmtuarit, apo nga ndonjë person tjetër përkatës.<sup>11</sup>

Ndërsa, në çështjet civile, prokuroria publike ka rol të kufizuar, pasi që funksioni i saj kryesor është ndjekja penale e kryesve të veprave penale. Por, në çështjet civile prokuroria publike ka funksionin e saj i cili është mbrojtja e interesit publik (interesit të përgjithshëm).<sup>12</sup>

### **3. Reformat në strukturën organizative të prokurorive**

Deri me 1 janar 2013, funksionin e Prokurorisë Publike në Republikën e Kosovës e kanë ushtruar:

- Prokurorët e prokurorive publike Komunale
- Prokurorët e prokurorive publike të Qarkut dhe
- Prokurori Publik i Kosovës.

---

<sup>10</sup> Ejup Sahiti, “E drejta e Procedurës Penale”, Prishtinë 2005, f. 82.

<sup>11</sup> Kodi i Procedurës Penale, 13 dhjetor 2012, neni 6, paragrafi 2-3.

<sup>12</sup> Faik Brestovci “E drejta Procedurale Civile”, Prishtinë 2006, f. 71.

Struktura figurative e Prokurorive në Republikën e Kosovës, para  
janarit të vitit 2013:



Nga 1 janari 2013 e tutje kemi këtë strukturë organizative të  
Prokurorisë së Shtetit:

- Prokuroria Themelore e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm, nga Departamenti për të Mitur dhe nga Departamenti për Krime të Rënda;
- Prokuroria e Apelit e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm dhe Departamenti për Krime të Rënda i Prokurorisë;

- Prokuroria Speciale dhe
- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

Lëndët që bien në kompetencë të Departamentit për Çështje Ekonomike ose Departamentit për Çështje Administrative pranë Gjykatës Themelore do t'u caktohen prokurorëve pranë Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore.<sup>13</sup> Pasi që nuk ekziston ndonjë departament i veçantë për çështjet ekonomike dhe administrative.

### **3.1. Themelimi i prokurorive themelore**

Prokuroria Themelore është instancë më e ulët në hierarkinë e prokurorive në Republikën e Kosovës. Ajo ka për detyrë ndjekjen e kryerësve të veprave penale ndaj personave vepra e të cilëve duhet të gjykohet në Gjykatën Themelore, në të gjitha departamentet apo divizionet e saj. Me dorëzimin e aktakuzës, nga prokurori i shtetit në Gjykatën Themelore, një gjyqtar i vetëm ose një koleg gjyqtarësh me kryetarin e tij, nga departamenti përkatës, caktohet nëpërmjet një procesi transparent e të drejtë për caktimin e çështjeve, për të gjykuar çështjen. Pas ngritjes së aktakuzës, nga prokurori i shtetit në Gjykatën Themelore, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues, mbanë shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin e dytë, merr vendim mbi kërkesat për hedhje të aktakuzës, merr vendim mbi kërkesat për të përjashtuar dëshmitë dhe merr vendim mbi kërkesën për caktim të paraburgimit apo masat tjera për të siguruar praninë e të pandehurit. Prokuroria Themelore ka juridiksion mbi të gjitha lëndët e shkallës së parë, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.<sup>14</sup>

### **3.2. Themelimi i Prokurorisë së Apelit**

Prokuroria e Apelit themelohet për të vepruar para Gjykatës së Apelit. Prokuroria e Apelit udhëhiqet nga Kryeprokurori i Prokurorisë i emëruar sipas Ligjit mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës. Prokuroria e Apelit ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Selia e Prokurorisë së Apelit është në Prishtinë. Prokurorët e emëruar në Prokurorinë e Apelit do të specializohen në përfaqësimin e ndjekjes penale para Gjykatës së Apelit. Kur një lëndë e prokurorisë prezantohet

---

<sup>13</sup> Ligji për Prokurorin e Shtetit, nr. 03/L-225, neni 14, paragrafi 1-3.

<sup>14</sup> Sadik Haxhiu – Flamur Hyseni, “Sistemi Gjyqësor në Republikën e Kosovës”, Gjilan 2013, f. 78-79.



para Gjykatës së Apelit, prokurori i cili ka iniciuar apo zhvilluar ndjekjen penale, me miratimin e Kryeprokurorit të Shtetit, mund të shoqërojë dhe ndihmojë Prokurorin e Shtetit të Prokurorisë së Apelit në paraqitjen e ankesës apo mbrojtjen kundër ankesës.<sup>15</sup> Kjo ndihmë ka për qëllim që Prokurori i Prokurorisë së Apelit të ketë bazë më të fuqishme ligjore për mbrojtjen e ankesës të parashtruar nga Prokurori i Prokurorisë Themelore ose mbrojtjes kundër ankesës të parashtruar nga palët pas shpalljes së aktgjykimit në Gjykatën Themelore.<sup>16</sup> Prokuroria e Apelit luan rolin e shkallës së dytë të prokurorive në Republikën e Kosovës.

### **3.3. Themelimi i Prokurorisë Speciale**

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës është themeluar pas shpalljes së pavarësisë përkatësisht në vitin 2010 dhe kjo prokurori përbëhet nga dhjetë prokurorë publikë të Kosovës. Prokurorët publikë të Kosovës, që punojnë si prokurorë specialë, do të jenë ata të cilët janë përzgjedhur dhe emëruar në përputhje me procedurat e përcaktuara sipas ligjit në fuqi. Përbërja e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës mund të ndryshohet sipas nevojave dhe ngarkesës me punë të zyrës dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara sipas ligjit në fuqi. Prokurorët special kanë kompetencë dhe përgjegjësi për të ushtruar funksionet e tyre, duke përfshirë edhe kompetencat dhe përgjegjësinë për të zhvilluar hetime dhe ndjekur penalisht krimet që janë në kompetencë të veçantë dhe plotësuese të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, në të gjitha prokuroritë dhe gjykatat që veprojnë në Kosovë.<sup>17</sup> Çdo herë që Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës merr përgjegjësi për një lëndë që është në kompetencë të saj të veçantë a plotësuese, organet e zbatimit të ligjit dhe prokurorët që punojnë në Kosovë do t'i ofrojnë Prokurorisë Speciale tërë ndihmën e kërkuar më qëllim të ushtrimit të drejtë të funksioneve dhe mandatit të kësaj zyre.

Prokuroria Speciale mund të bashkërendojë dhe drejtojë hetimin dhe ndjekjen penale të lëndëve që janë në kompetencë të saj të veçantë a plotësuese nëpërmjet zyrave të prokurorëve të ndryshëm që punojnë në Kosovë. Prokurorët special do të kërkojnë dhe marrin ndihmë nga Kryeprokurorët që punojnë në Kosovë, në çdo kohë që ata veprojnë, për të bashkërenduar dhe drejtuar hetimin dhe ndjekjen penale të lëndëve

---

<sup>15</sup> Ligji për Prokurorin e Shtetit, nr. 03/L-225, neni 16, paragrafi 1-4.

<sup>16</sup> Sadik Haxhiu – Flamur Hyseni, “Sistemi Gjyqësor në Republikën e Kosovës”, Gjilan 2013, f. 80.

<sup>17</sup> Ligji për Prokurorinë Speciale, nr. 03/L-052, neni 7, paragrafi 3.5.

për të cilat Prokuroria Speciale ka marrë përgjegjësi. Me autorizimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale, prokurorët special mund të delegojnë, tek çdo prokuror që punon në Kosovë, ndërmarrjen e aktiviteteve dhe veprimeve të veçanta të procedurës penale ose kryerjen e hetimeve apo ndjekjen penale të lëndëve për të cilën Prokuroria Speciale ka marrë përgjegjësi.<sup>18</sup>

Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale do të informojë, brenda afatit të përgjithshëm që do të përcaktohet nga Kryeprokurori publik i Kosovës, Kryeprokurorin e zyrës që ka juridiksion mbi lëndën, lidhur me autorizimin e dhënë në pajtim me ligjin. Kryeprokurori i zyrës mund të kërkojë nga Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të rishqyrtojë vendimin lidhur me delegimin e veprimeve të veçanta procedurale apo të hetimit a ndjekjes specifike penale. Në rrethana të delegimit të një hetimi a ndjekje të veçantë të rastit, prokurori i identifikuar sipas ligjit do të informojë prokurorin special përgjegjës lidhur me zhvillimet përkatëse që kanë të bëjnë me procedurën. Në çdo kohë, gjatë procedurës, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, do të ketë kompetencë që të tërheqë, për arsye të besueshme, hetimin ose ndjekjen e deleguar, duke u bazuar në ligj.<sup>19</sup>

Gjithashtu, sikurse në sistemin gjyqësor ashtu është zbatuar plani edhe në sistemin prokurorial që për tu zbatuar struktura e re e prokurorisë publike, është paraparë mënyrë e zbatimit të kësaj strukture në dy faza:

1. Faza planifikuese: Nga 1 janari 2011 deri 31 dhjetor 2011, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka përgatitur planin implementues për lehtësimin e tranzicionit nga ish sistemi prokurorial në sistemin e ri prokurorial.

2. Faza implementuese: Nga 1 janari 2012 deri në 31 dhjetor 2012, Këshilli ka nisur implementimin e planit.<sup>20</sup>

Njashtu ia vlen të ceket se, sistemi prokurorial në Republikën e Kosovës, deri në vitin 2010 ka funksionuar në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në vitin 2010 është themeluar Këshilli Prokurorial, dhe gjithë sistemi prokurorial është bartur në Këshillin Prokurorial, çka do të thotë që nga viti 2010 sistemi prokurorial në Republikën e Kosovës funksionon në kuadër të Këshillit Prokurorial.

---


<sup>18</sup> Po aty, neni 3, paragrafi 3.7.

<sup>19</sup> Po aty, neni 3, paragrafi 3.10.

<sup>20</sup> Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS); Ri-themelimi dhe reformimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë 1999-2011, Prishtinë 2011.

## CENTRUM 5

Struktura e re figurative e Prokurorive në Republikën e Kosovës,  
nga janari të vitit 2013:



## **Conclusion**

Likewise, I think that this reform will also fasten the investigation of cases as the inefficiency of the investigation was a major flaw of the prosecutorial system in Kosovo. I hope that this reform will have a more independent, more efficient, apolitical and impartial prosecutorial system.

Also worthwhile to note that today the prosecutorial system in Kosovo is said to be an independent system, yet there are political influences and interferences by certain persons, which also prevents the functioning of this system in democratic order based on the constitution and laws of the State of the Republic of Kosovo.

Even after these reforms were made in the prosecutorial system of the Republic of Kosovo, there is still a small number of prosecutors and administrative staff prosecution in Kosovo, which is negatively affecting the collection of materials and the inefficiency of the work of the prosecutorial system in Kosovo. Hopefully there will be other actions taken by the competent authorities relating to the appointment of other young prosecutors and administrative staff expansion prosecution, in order to increase the efficiency of work of all the prosecutorial system in Kosovo.

I hope that this paper will serve all professors, scientists, judges, prosecutors, students and all people dealing with legal issues.

## **Bibliografi**

1. Bajrami, Arsim: “Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës”, Prishtinë 2011.
2. Bajrami, Arsim – Shala, Xhavit: “Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës”, Prishtinë 2009.
3. Bashkim Dr.Selmani „Kriminologji me Penologji”-Kolegji „FAMA”-Prishtinë, 2013.
4. Brestovci, Faik: “E drejta Procedurale Civile”, Prishtinë 2006.
5. Bashkim Dr.Selmani „Krimi i organizuar dhe terrorizmi”-Universiteti parë privat „FON”-Shkup, 2009.
6. Hajdari, Azem: “E drejta e Procedurës Penale”, Prishtinë 2010.
7. Haxhiu, Sadik – Hyseni, Flamur: “Sistemi Gjyqësor në Republikën e Kosovës”, Gjilan 2013.

8. Ramajli, Iljaz: “Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës”, Prishtinë 2004.

9. Sahiti, Ejup: “E drejta e Procedurës Penale”, Prishtinë 2005.

10. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS); Ri-themelimi dhe reformimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë 1999-2011, Prishtinë 2011.

### **Burimet e legjislacionit – Aktet juridike**

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
- Kodi i Procedurës Penale, 13 dhjetor 2012.
- Ligji për Prokurorin e Shtetit, nr. 03/L-225.
- Ligji për Prokurorinë Speciale, nr. 03/L-052